



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 11

Tiranë – E premte, 27 janar 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt Normativ i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 25.1.2017	313
Për disa ndryshime në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	



AKT NORMATIV
Nr. 1, datë 25.1.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR.9136, DATË 11.9.2003, “PËR
MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË
DETYRUESHME TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, duke marrë në konsideratë boshllëkun ligjor të krijuar nga vendimi nr.60/2016, i Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të nenit 4, të ligjit nr.143/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9136, datë 11.9.2013, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe efektet e ndërsjella për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si për të vetëpunësuarit edhe për buxhetin e shtetit, duke marrë në konsideratë kohën e pamjaftueshme për të bërë rregullimet ligjore, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 3, e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit edhe për punonjësit e papaguar të familjes.”.

Neni 2

Neni 7, “Regjistrimi në organet tatimore”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 7

Regjistrimi i të punësuarëve në organin
tatimor

Personat juridikë ose fizikë, brenda dy ditëve pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore, deklarojnë

në organin tatimor listën e të punësuarve, pagën përkatëse, përfshirë për personin fizik edhe punonjësit e papaguar të familjes mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht.

Për personat fizikë të vetëpunësuar pa punëmarrës dhe pa punonjës të papaguar të familjes mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon dhe bashkëjeton ligjërisht, pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore, ky deklaram në organin tatimor bëhet të paktën 3 ditë përpara afatit të paraqitjes së deklaratës, siç përcaktohet në nenin 11, të këtij ligji, por llogaritja e detyrimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet me efekte nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore.”.

Neni 3

Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Llogaritja e kontributeve për personin e
vetëpunësuar dhe punonjësin
e papaguar të familjes

1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar, llogariten si përqindje mbi një pagë bruto, jo më të ulët se paga minimale në shkallë vendi dhe jo më të lartë se paga maksimale, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për punonjësin e papaguar të familjes llogariten mbi pagën minimale në shkallë vendi, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes, llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje mbi dyfishin e pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kur veprimtaria ekonomike e tatimpaguesit fillon, ndërpritet, përfundon apo kalon në regjistrin pasiv gjatë një muaji, llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore bëhet në bazë të pagës për ditët e punuara për muajin.”.



Neni 4

Dispozita të fundit

Me hyrjen në fuqi të këtij akti normativ shfuqizohen:

a) nenet 1 dhe 2, të ligjit nr.144/2015, “Për disa shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, që ka shtuar shkronjën “d”, të nenit 6, dhe paragrafin e shtuar, pas paragrafit të katërt, të nenit 9, të ligjit;

b) nenet 1, 2 dhe 3, të ligjit nr.145/2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimet e detyrueshme të kujdesit

shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, që ka ndryshuar përkatësisht nenin 5, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”; nenin 6, pikën 1 dhe paragrafin e dytë, të pikës 3, të nenit 7, të ligjit.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë